



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:113459

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05856919

Ac.nr.1328/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore e paditëses KS “Sigma InterAlbanian Vig”, rr.”Ukshin Hoti”, nr.13 me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Selim Zejnullahu, kundër të paditurit B.H. nga Gj....., rr....., baza juridike rimbursimit e dëmit të paguar, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.447/2017, i datës 21.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht si e pathemeltë ankesa e të paditurit: B.H. nga Gj....., rr....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.447/2017 të datës 21.12.2021, në piken I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë sa i përket rimbursimit të dëmit material në shumën prej 568.00 euro, VËRTETOHET.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurit: B.H. nga Gj....., rr....., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.447/2017 të datës 21.12.2021, në piken I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë ku është vendosur për kohën nga e cila duhet të rrjedhë kamatëvonesa për rimbursimin e dëmit material, ashtu që për rimbursimin e dëmit material kamata duhet të rrjedhë nga momenti i paraqitjes së padisë datë 15.06.2017.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.447/2017, i datës 21.12.2021 ka vendosur si në vijim: **I.** Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses KS “Sigma InterAlbanian Vig” me seli në Prishtinë dhe detyrohet i padituri që paditëses t’i rimbursojë dëmin në lartësi prej 568.00 €, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të dt. 20.03.2016 në fsh....., Gj....., me kamatë siç paguajnë bankat në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të veçantë, duke llogaritur nga data 08.04.2016 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor. **II.** Detyrohet i padituri që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, i padituri duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lënda të kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë apo të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë dike refuzuar padinë e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datë 15.06.2017, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar rimbursimin e dëmit të paguar me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.447/2017, i datës 21.12.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Gjykata, duke u bazuar në nenin 8 të LPK-ës, duke vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:- Se me datë 20.03.2016, rreth orës 21:45minuta, në fsh....., i padituri B.H. duke drejtuar automjetin „AUDI A6” me targa 06....., pronë e A.A, pa poseduar leje të vlefshme për drejtimin e kësaj kategorie të automjeteve, ka shkaktuar aksident trafiku dhe si pasojë e saj i ka shkaktuar dëm material në automjetin VW 2K CAD me targa 05....., pronë e V.A, me ç’rast të dëmtuarit V.A nga Gj..... nga ana e paditëses i është kompensuar shuma prej 568.00€. Këto fakte nuk janë kontestuar fare nga ana e të paditurit, pasi që faktet e tilla i konfirmojnë provata materiale të administruara edhe atë; Raporti policor me numër të rastit 2016-CR-88, i datës 20.03.2016; Konfirmimi i sigurimit sipas policisë së sigurimit 0005702144 e datës 23.03.2016 lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “SIGMA”; Deklarata për pranimin e vlerës për dëmshpërblim, e lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “SIGMA” dhe e nënshkruar nga ana e V.A në lartësi prej 568.00 euro; Urdhër pagesa e datës 08.04.2016 e lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “SIGMA” lidhur me kompensimin e dëmit material për të siguruarin Artan Hasani; Kopja e pasqyrës së qarkullimit, respektivisht transaksioni për periudhën kohore 12.04.2016.

Tutje Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se meqenëse provat materiale nuk janë kontestuar nga ana e të paditurit, Gjykata ka vendosur si në pikën e parë të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar me ligj, pasi që një e drejtë e tillë e paditëses dhe detyrim i tillë për të paditurin bazën juridike e ka në nenin 18 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia/ *Ligji Nr. 04/ L-018 23 qershor 2011/* ku parashihet se „Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat” lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit të lartëcekur, në të cilën dispozitë është përcaktuar se, *i siguruarari e humbë mbulesën siguruese kur; drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit;* dhe meqë i padituri nuk kishte leje valide për drejtim të automjetit, përgjegjësia për shkaktimin e dëmit bie mbi te, respektivisht detyrimi për rimbursimin e dëmit paditëses.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit e mbështet në tërësi përfundimin e Gjykatës së shkallës së parë në raport me vendosjen për aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses për arsye se edhe për këtë Gjykatë rezulton të provohet fakti se i padituri është i obliguar që t'i paguajë paditëses rimbursimin e dëmit dhe atë për faktin se nga shkresat e lëndës respektivisht nga raporti i aksidentit 2016-CR-88 dt.20.03.2016 vërtetohet se policia në raportin në fjalë ka konstatuar se i padituri ka drejtuar automjetin pa pasur patent shofer e që qon edhe në humbjen e mbulesës siguroese. Se nuk ka qenë kontestuese se aksidenti ka ndodhur me dt.20.03.201 dhe se aksidenti ka ndodhur me fajin e të paditurit, ku kjo vërtetohet raporti i aksidentit ku konstatohet se i njëjti ka ndodhur si pasoj e lëshimeve të të paditurit dhe se i njëjti nuk kishte patentë shofer ne kohen kur ka ndodhur aksidenti, po ashtu lartësia e demit nuk ka qen kontestuese të gjitha këto fakte nuk jan kontestuar nga i padituri në sencen e dt.21.12.2021.

Meqenëse i padituri ka qenë i siguruar tek tani paditësja e njëjta në bazë të përgjegjëses edhe e ka paguar demin shkaktuar personave të tret e që këtë fakt Gjykata e vërteton përmes faturave përkatësisht fletëpagesave që gjenden në shkresat e lendes.

Gjykata e Apelit e mbështet në tërësi përfundimin e Gjykatës së shkallës së parë në raport me vendosjen për aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses për arsye se edhe për këtë Gjykatë rezulton të provohet fakti se i padituri është i obliguar që t'i paguajë paditëses rimbursimin e dëmit dhe atë për faktin se nga shkresat e lëndës respektivisht nga raporti i aksidentit 2016-CR-88 vërehet se policia në raportin në fjalë ka konstatuar se i padituri ka drejtuar automjetin pa pasur patentë shofer e që qon edhe në humbjen e mbulesës siguroese.

Si rezultat i vërtetimit të plotë dhe të gjendjes faktike edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë ku Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta e paditëses për kërkesën e rimbursimit të dëmit gjen mbështetje në me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018, Humbja e mbulesës siguroese është paraparë se “1.2 I siguruari e humbë mbulesën siguroese, kur: **drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik**, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimimit, 1.3. mjeti motorik drejtohet nën ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psiko-aktive;1.4. drejtuesi e shkakton dëmin me dashje; 1.5. aksidenti ndodh për shkak të defekteve teknike të mjetit për të cilat drejtuesi, poseduesi apo pronari kanë qenë në dijeni për to”, me paragrafin 2 të këtij neni është paraparë “Humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohen me dispozitat e paragrafit 1. nën-paragrafët 1.1 deri 1.5, të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim”, ndërsa me paragrafin 3 të po këtij neni, është paraparë se: “Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe

paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese”. Meqenëse pra në rastin konkret i padituri e ka drejtuar automjetin pa patën shofer, i njëjti edhe ka humbur mbulesën siguroese, andaj ka për detyrim që t’ia rimbursoj mjetet të cilat i ka paguar paditësja për kompensimin e dëmit palëve të treta të dëmtuara.

Paditësja ka lidhur marrëveshje jashtëgjqësore me personat e tretë, ashtu që si pasojë e aksidentit të shkaktuar janë shkaktuar lëndime trupore dhe dëme materiale dhe me këtë rast pasi që vetura me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë e siguruar tek paditësja, e njëjta e ka bërë kompensimin e dëmit ndaj personave të tretë në shumë prej 568 euro, e kjo vërtetohet saktë nga pagesat që gjenden në shkresat e lëndës.

Pra në rastin konkret, meqenëse dëmi është shkaktuar dhe paditësja ka bërë kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarve, e njëjta ka të drejtë regresi nga personi përgjegjës lidhur me shumën e paguar të dëmtuarës. Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur kërkesëpadia e paditëses është aprovuar si e bazuar, sepse nga dispozitat ligjore të njëjtës i buron e drejta e regresit ndaj të paditurit.

Gjykata e Apelit, e ka pranuar në tërësi përfundimin e shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadiës, sa i përket pjese vërtetuese, ngase edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje juridike kontestuese.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kamatës ligjore, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale. Gjykata në këtë kontekst i ka pranuar pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me kamatën, prandaj aktgjykimi është ndryshuar sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, ashtu që kamata ligjore është llogaritur duke filluar nga data e paraqitjes së padiës 15.06.2017, e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij, nuk kishte parashtruar kërkesë të i padituri për rimbursimin e demit nga i padituri para se te paraqitet padia.

Sa i përket vendimin mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në pajtim me dispozitat e 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata ankimore vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjta i gjeti pa ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1328/2022, me datë 24.06.2024

Kryetar i kolegjit
Naim Mehollli d.v.